

PYETJE NGA LËNDA E GJEOGRAFISË

1. Sa është e madhe sipërfaqja e Kosovës?



Sipërfaqja e Kosovës është afër 11000 km katrore. Kosova gjendet ne mes te Europës Jug-Lindore. Shtrihet mes paraleles 42 e 44 të hemisferës veriore të Tokës dhe mes meridianit 20 e 22. Duke zënë pozitë qendrore ne Gadishullin Ballkanik, paraqet nje të rëndësishme të lidhjes midis, Europës së Mesme dhe asaj Jugore, Detit Adriatik dhe Detit te Zi.

2. Sa është sipërfaqja e Shqipërisë?



Sipërfaqja e Shqipërisë është afër 29000 km². Shqipëria shtrihet në pjesën juglindore të Evropës, në pjesën perëndimore të gadishullit Ballkanik midis koordinatave gjeografike 39 gradë e 38' dhe 42 gradë e 39' te gjërësisë veriore dhe 19 gradë e 16' të gjërësisë lindore, në largësi pothuajse të barabartë nga Ekuadori dhe Poli i Veriut. Gjatësia e përgjithshme e vijës kufitare është 1094 km, nga të cilat 657 km - kufi tokësor, 316 km - kufi detar, 48 km - kufi lumor dhe 73 km - kufi liqenor.

3. Sa banorë jetojnë në Kosovë?

Në Kosovë jetojnë mbi 2 milion banorë, prej tyre 92 % janë shqiptarë etnik. Në Kosovë jeton edhe një numër i vogël i pakicave nacionale. Ka pak serbë, turqë, myslimanë, romë, malazezë etj. Një kohë të gjatë, për arsye të njohura nuk është bërë regjistrimi i popullsisë në Kosovë. Në kushte normale shtetet zakonisht bëjnë regjistrimin e popullsisë në çdo 10 vjet.

4. Sa banorë ka Shqipëria?

Shqipëria ka mbi 3,8 milion banorë. Edhe në Shqipëri jetojnë disa pakica kombëtare si bie fjala grekë, romë, maqedonë etj.

5. Cili ishte emri i Kosovës në kohën e ilirëve?

Territori i Kosovës në kohën e ilirëve quhej Dardani. Etimologjia e fjalës Dardani spjegohet me elemente të shqipes: dardhë- vend i dardhave (Dardhania). Dallimi i vjetër që pala shqiptare mund të bënte ishte shqiptimi ndryshe nga Kosova, në Kosova shqip. Presidenti Rugova përpiqej për përgatitjen e terrenit në mënyrë që kur të shpallej pavarësia e Kosovës, Kosova të ndryshoje emrin në Dardani-emrin e saj të origjinës.

6. Cilat janë disa nga qytetet e lashta antike që ndodheshin në tokat shqiptare?



Rrënojat e Ulpianës

Qytete t ë lashta antike që ndodheshin në tokat shqiptare ishin Apollonia, Dyrrahu, Shkodra, Ulpiana etj. Ulpiana ishte një qytet ilir i themeluar në fillim të shekullit II nga perandori Trajan. Gërmimet arkeologjike kanë dhënë gjurmë të jetës pararomake në këtë qytet. Qyteti ndodhej afër Prishtinës.

7. Në cilën pjesë të Evropës shtrihet Kosova dhe viset tjera shqiptare?



Kosova dhe viset tjera shqiptare shtrihen në pjesën e Europës jug- lindore. Shkencërisht trualli i shqiptarëve ishte territor kompakt me 115 mijë km katrore. Nga Kongresi i Berlinit -1878, gjer me sot është ngushtuar në 55 gjer 65 mijë km katrore në të cilat populli shqiptar është shumicë. Në Konferencën e Ambasadorëve në Londër me 1912/1913, shteti shqiptar u krijua në një sipërfaqe prej pak më shumë se 28 mijë km katrore. Pas vitit 1912 shumë territore kompakte shqiptare mbeten jashtë kufijve shtetëror të Shqipërisë zyrtare.

8. Me cilat vende kufizohet Kosova ?



Kosova kufizohet në veri me Serbinë, në juglindje me Republikën e Maqedonisë, në jugperëndim me Shqipërinë dhe në perëndim me Malin e Zi.

9. Me cilat vende kufizohet Shqipëria?



Shqipëria kufizohet nga Mali i Zi në veriperëndim, Kosova në veri, nga Maqedonia në lindje dhe Greqia në jug. Në kufirin natyror perëndimor Shqipëria ka dalje të hapur në Detin Adriatik dhe në jug-perëndim në Detin Jon.

10. Cili është kryeqyteti i Kosovës?



Stema e kryeqytetit

Kryeqyteti i Kosovës është Prishtina. Prishtina është qendra administrative, akademike dhe kulturore e Kosovës. Prishtina ka edhe aeroportin ndërkombëtar. Nëpër Prishtinë kalojnë rrugë të rëndësishme të Europës jug-lindore për të lidhur qendra të ndryshme tregtare të rajonit. Në Prishtinë janë të përqëndruar të gjitha ambasadat e huaja.

11. Cilat janë qytetet kryesore të Kosovës?



Qytetet kryesore të Kosovës janë: Prishtina, Prizreni, Peja, Mitrovica, Gjlani, Ferizaj etj.

12. Cili është kryeqyteti i Shqipërisë?




Kryeqyteti i Shqipërisë, Tirana



Stema e Tiranës

Kryeqyteti i Shqipërisë është Tirana. Tirana shtrihet në pjesën qendrore të Shqipërisë. Ishte e banuar që në antikitet mirëpo historia e qytetit është relativisht e re. U themelua nga Sulejman Pasha në vitin 1614. Në kohën e mbretit Zog qyteti u ndërtua në stilin italian dhe u bë kryeqendër e Shqipërisë. Sot ka mbi 600 000 mijë banorë. Tirana është epiqendra kulturore e shqiptarëve dhe një metropolë e rëndësishme e Ballkanit.

13. Cilat janë qytetet kryesore të Shqipërisë?



Qytetet kryesore të Shqipërisë janë Tirana, Shkodra, Durrësi, Vlora, Elbasani, Korça etj.



Shkodra




Durrësi



Vlora



Elbasani



Korça

14. Cilat janë qytetet kryesore shqiptare në Maqedoni?

Qytetet kryesore shqiptare në Maqedoni janë: Shkupi, Tetova, Gostivari, Kumanova, Dibra, Struga, Ohri etj.



Shkupi



Tetova



Gostivari



Kumanova



Dibra



Struga



Ohri

15. Sa është numri i shqiptarëve që jetojnë në Maqedoni?

Në Maqedoni jetojnë 800 000 shqiptarë autokton në trojet e tyre etnike. Shqiptarët në Maqedoni janë popull autokton. Në antikitetin e hershëm Shkupi ishte qendër e njohur ilire kurse më vonë qyteti më me shumë shqiptarë në Ballkan. Ishte edhe seli e ngjarjeve historike e kulturore të shqiptarëve.

16. Cilat janë malet kryesore në viset shqiptare në Maqedoni?



Malet kryesore në viset shqiptare në Maqedoni janë malet e Sharrit, Korabit, Pelisterit, Karadaku i Shkupit etj.

Në kufirin Kosovë, Maqedoni e Shqipëri shtrihen malet e Sharrit.

17. Cilat janë qytetet kryesore shqiptare në Mal të Zi ?

Qytetet kryesore shqiptare në Mal të Zi janë: Tivari, Tuzi, Plava, Gucia, Ulqini, Rozhaja etj.



Tivari



Tuzi



Plava



Gucia



Ulqini



Rozhaja

18. Cili është qyteti më i njohur turistik në Mal të Zi ?



Ulqini

Qyteti më i njohur turistik në Mal të Zi është Ulqini. Ulqini është njëri ndër qytetet më të vjetra në bregdetin e Adriatikut. Që në kohët e lashta e deri në fund të shekullit XIX, për shkak të pozitës së vet gjeografike, ishte në shënjestër të pushtuesve të ndryshëm. Mbi 80 % e popullsisë është shqiptare. Është qytet atraktiv turistik.

19. Cilat janë qytetet kryesore shiptare në Kosovën lindore?

Qytetet kryesore shqiptare në Kosovën lindore janë: Presheva, Bujanoci dhe Medvegja. Këto tri qytete përbëjnë sot lokalitetin që njihet edhe me emrin Lugina e Preshevës.



Presheva



Bujanovci



Medvegja

20. Cilat janë qytetet kryesore shqiptare të Çamërisë?

Qytetet kryesore shqiptare të Çamërisë janë: Janina, Arta, Preveza etj.



Janina



Arta



Preveza

21. Në cilat shtete të Europës ka më së shumti shqiptarë të shpërngulur nga trojet etnike?



Harta e Europës

Më së shumti shqiptarë të shpërngulur nga trojet etnike ka në Turqi, Gjermani, Zvicër, Suedi, Austri etj. Gjatë historisë se vetë shqiptarët shumë herë u detyruan të shpërngulen.

22. Në sa rrafshe ndahet Kosova dhe cilët janë ato rrafshe?



Kosova ndahet në dy rrafshe: në Rrafshin e Dukagjinit dhe në Rrafshin (fushën) e Kosovës. Rrafshi i Dukagjinit shtrihet kryesisht në pellgun e Drinit të Bardhë, ka lartësi mbidetare më të vogël se fusha e Kosovës dhe është i njohur si rajon bujqësor. Ndërsa Rrafshi i Kosovës është i njohur si rajon i pasurive minerare. Si vijë kufizuese e menduar merret vija e përafërt ajrore Mitrovicë-Kaçanik.

23. Cilat janë malet kryesore të Kosovës?

Malet kryesore të Kosovës janë Malet e Sharrit, Koritnikut, Gjeravica, Bjeshkët e Nemuna, Hajla, Malet e Gollakut, Pashtriku etj.

24. Cila është maja më e lartë në Kosovë dhe sa është lartësia e saj?



Maja e Gjeravicës gjatë natës.

Maja më lartë në Kosovë gjendet në Malet e Gjeravicës dhe është e lartë 2 656m. Kjo maje malore gjendet në perëndim të Kosovës, në vargmalet e Bjeshkëve të Nemuna që ndajnë kufirin e komunës së Deçanit me Shqipërinë. Maja e Gjeravicës gjendet në gjerësinë gjeografike veriore 42.53° dhe 42.53° të gjatësisë gjeografike lindore. Kjo maje është njëra nga atraksionet turistike më të vizituara nga alpinistët e shteteve të ndryshme që nga viti 1975.

25. Cilat janë malet kryesore të Shqipërisë?

Malet kryesore të Shqipërisë janë Alpet Shqiptare, Korabi, Tomori, Kurveleshi etj.

26. Cila është maja më e lartë e Shqipërisë?



Maja e Korabit

Maja më lartë në Shqipëri është Korabi me mbi 2 751 metra lartësi mbi detare. Maja e Korabit përbën pjesën më të lartë të krejt vargmalit me të njëjtin emër , duke qenë jo vetëm mali me i lartë i Shqipërisë (2751m) por edhe një nga më të lartët e Gadishullit Ballkanik. Korabi shtrihet midis luginës së përroit të Veleshicës dhe asaj të përroit të Grames.

27. Çfarë klime ka Kosova dhe çka e karakterizon këtë klimë?

Kosova ka klimë kontinentale me verëra të nxehta e pak reshje dhe dimra të ftoftë e me shumë reshje. Përmes grykës së Drinit vjenë deri në Prizren e rrethinë butësia e klimës mediterane.

28. Cilët janë lumenjtë kryesorë të Kosovës?

Lumenjtë kryesorë të Kosovës janë Drini i Bardhë me degët e tij Lumbardhin e Pejës, Deçanit dhe Prizrenit, Ereniku, Mirusha, Ibri, Lepenci, Nerodinja etj.

29. Cili është lumi më i gjatë në Kosovë ?



Drini është lumi më i gjatë i trojeve shqiptare më 285 km. Ai derdhet në Detin Adriatik. Afër qytetit të Kukësit bashkohet me dy degët kryesore të tij: Drinit të Bardhë që buron afër Pejës-Kosovë dhe Drinit të Zi që buron në Shën Naum-Maqedoni. Drini është lumi më i madh në gjithë pjesën perëndimore të Ballkanit.

Burimi i Drinit të Bardhë në Radavc të komunës së Pejës.

30. Cilët janë lumenjtë kryesorë të Shqipërisë?

Lumenjtë kryesor të Shqipërisë janë: Drini, Buna, Shkumbini, Vjosa, Erzeni etj

31. Cilët janë liqenet kryesore të Kosovës?

Liqenet kryesore të Kosovës janë: Liqeni i Batllavës, Badovcit, Radoniqit etj. Liqeni i Batllavës shtrihet në komunën e Besianës, Liqeni i Badovcit gjendet në afërsi të Prishtinës kurse Liqeni i Radoniqit në Gjakovë. Qe të tre janë liqene artificiale.



Liqeni i Batllavës



Liqeni i Badovcit



Liqeni i Radoniqit

32. Cilat janë fushat kryesore të Shqipërisë?

Fushat kryesore të Shqipërisë janë : Fusha e Myzeqesë, Zadrimës, Shkodrës, Elbasanit etj.

33. Cilët janë liqenet kryesore të Shqipërisë ?

Liqenet kryesore të Shqipërisë janë: Liqeni i Ohrit, Prespës, Shkodrës etj. Në bregun e liqenit të Ohrit shtrihen tre qytete të mëdha: Ohri dhe Struga në Maqedoni Pogradeci në Shqipëri. Liqeni i Prespës i takon Maqedonisë, Shqipërisë dhe Greqisë. Liqeni i Shkodrës është liqeni më i madh në Ballkan. Në breg të këti liqeni shtrihet Shkodra, një qytet i vjetër dhe i bukur shqiptar.



Liqeni i Ohrit



Liqeni i Prespës



Liqeni i Shkodrës

34. Cilat janë disa nga portet kryesore të Shqipërisë?

Portet kryesore detare të Shqipërisë janë: porti detar i Durrësit dhe ai i Vlorës.



Porti i Durrësit



Porti i Vlorës

35. Nga ujërat e cilave dete lagen brigjet e Shqipërisë?

Brigjet e Shqipërisë lagen nga ujërat e Detit Adriatik dhe Detit Jon. Shqipëria përmes ngushticës Otranto lidhet edhe me Detin Mesdhe.

36. Cili është ishulli më i madh në Shqipëri?



Ishulli i Sazanit

Ishulli më i madh në Shqipëri është ishulli i Sazanit. Vetëm 17 km larg Portit ndodhet i vetmi ishull i Shqipërisë, Sazani. Maja e tij më e lartë është 342 m. Ishulli i Sazanit ka sipërfaqe 5,7 km² dhe vijë bregdetare me gjatësi 12 km. Kjo është vijë bregdetare e thyer me përbërje shkëmbore monolitike.

37. Si quhet ngushtica detare në mes të Shqipërisë dhe Italisë?



Ngushtica e Otrantos

Ngushtica detare në mes të Shqipërisë dhe Italisë quhet ngushtica e Otrantos. Largësia mes Shqipërisë e Italisë është vetëm 78 km në këtë ngushticë. Thellësia mesatare e detit është mbi 800 metra.

38. Pse është i njohur lumi i Nerodimes?




Bifurkacioni i lumit Nerodime në Ferizaj.

Lumi i Nerodimes është i njohur për bifurkacionin e tij. Ujërat e këtij lumi ndahen në dy drejtime dhe derdhen në dy dete, në Detin e Zi dhe në Detin Egje.

39. Në cilat dete derdhen ujërat e lumenjve të Kosovës?

Ujërat e lumenjve të Kosovës derdhen në tri dete, në Detin Egje, në Detin e Zi dhe në Detin Adriatik.

40. Cilat janë xeheroret më të njohura në Kosovë dhe cilat xehe nxirren aty?



Miniera e Trepçes në Mitrovicë

Xeheroret më të njohura në Kosovë janë: Trepça, Kishnica dhe Novobërda, në të cilat nxirret xehja e plumbit dhe e zingut. Ka edhe xeherore tjera. Trepça është miniera më njohur në Kosovë dhe Europë. Emri Trepçë vjen nga shqipja që do të thotë tri furra për shkrirje. Trepça (TRE+PÇA), pjesa e dytë e emrit vjen nga fjala "PÇA" që do të thotë "poça" (me pjekë). "TRI FURRAT"-dikur, sot TREPÇA.

41. Cilat janë disa nga bukuritë e rralla të Kosovës ?

Disa nga bukuritë e rralla të Kosovës janë: Shpella e Mermertë në Gadime, Gryka e Rugovës, Gryka e Kaçanikut, Gryka e Carralevës, burimi i Drinit të Bardhë , Ujëvarat e lumit Mirusha etj.



Shpella e Gadimes

Gryka e Rugovës

Gryka e Kacanikut

Gryka e Carralevës

Drini i Bardhë

Mirusha

42. Cila është shpella më e njohur në Kosovë?



Shpella më e njohur në Kosovë është Shpella në fshatin Gadime në afërsi të Lipjanit. Ajo është e gjatë 1500 metra. Gjatë verës temperatura në brendi të shpellës është 8-11 gradë celsius dhe gjatë dimrit 11-13 gradë. Shpella është gjetur rastësisht nga një fshatar teksa po nxirrte gurë në oborrin e tij.

Vendi ku u zbulua Shpella e Mermertë në Gadime.

43. Çka kuptoni ju me fjalët “natalitet” dhe “mortalitet”?

Me fjalën ”natalitet” kuptohet numri i përgjithshëm i lindjeve të fëmijëve në një vend, kurse me fjalën ”mortalitet” kuptohet numri i vdekjeve së popullsisë në një vend.

44. Çka kuptojmë me fjalët “kufi etnik” dhe “kufi shtetëror”?

Me fjalët ”kufi etnik” kuptojmë kufijtë në mes të popujve të ndryshëm që dallojnë për nga kombësia e tyre, kurse me ”kufi shtetëror” kuptojmë kufijtë e shteteve që mund të kenë popullsi me kombësi të njëjtë si p. sh. kufiri mes Kosovës dhe Shqipërisë.

45. Në cilin vit u lëshua për qarkullim autostrada Durrës – Kukës - Morin?



Autostrada Durrës-Kukës-Morin u lëshua për qarkullim në qershor të vitit 2009. Rruga lidh bregdetin Adriatik me Kosovën. Është e gjatë 170 km. Tuneli (6 kilometra) në Kalimash është një nga më të gjatët në Ballkanin perëndimor.

46. Sa komuna ka në Kosovë?

Në zgjedhjet e fundit në Kosovë (15 nëntor 2009) moren pjesë 35 komuna.

47. Cili qytet i Maqedonisë është qendër universitare shqiptare?



Qendër universitare shqiptare në Maqedoni është Tetova. Universiteti u themelua më 17 dhjetor 1994, me iniciativën e intelektualëve shqiptarë të Republikës. Pas një pune 10 vjeçare u zyrtarizua nga Qeveria e Maqedonisë më 20 shkurt 2004 .

Stema e Universitetit në Tetovë.

48. Cilat janë kanionet më të njohura në Kosovë?

Kanionet më të njohura në Kosovë janë ai i Grykës së Rugovës, Grykës së Kaçanikut, lumit Mirusha etj.



Kanioni Rugovës



Kanioni i Kaçanikut



Kanioni i lumit Mirusha

49. Cilat kafshë të egra jetojnë në viset shqiptare?

Në viset shqiptare jetojnë: ariu, ujku, dhelpra, lepuri, ketri, derri i egër, dreri etj.

50. Cilat lloje të drurëve rriten në viset shqiptare?

Në viset shqiptare rriten ah, qarri, bungi, plepi, gështenja, thana etj.

51. Në cilin vit u përruan 38 km e autostradës së parë në Kosovë Vermisë-Merdare?

38 km e para te autostradës Vermisë – Merdare u përruan më 12 nëntor 2011. Kjo autostradë mbanë emrin e Dr. Ibrahim Rugoves dhe do të jetë e gjatë 118 km. Është një nga autostradat më moderne në rajon.